



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.30

23 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 239, datë 25.2.2010	Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave.....	1007
Ligj nr.10 240, datë 25.2.2010	Për disa shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.....	1009
Ligj nr.10 241, datë 25.2.2010	Për simbolet e përkujtimit të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri.....	1012
Ligj nr. 10 242, datë 25.2.2010	Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.....	1013
Vendim i Kuvendit nr.25, datë 19.3.2010	Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për transparencën e zgjedhjeve të përgjithshme, të mbajtura më 28 qershor 2009.....	1020
Vendim i KM nr.104, datë 17.2.2010	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2010, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare.....	1021

LIGJ
Nr. 10 239, datë 25.2.2010

PËR KRIJIMIN E FONDIT SPECIAL TË KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i fondit të kompensimit të pronave, burimet e krijimit dhe rregullat për administrimin e tij.

Neni 2
Fondi i kompensimit të pronave

1. Fondi i kompensimit të pronave është fondi i krijuar me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

2. Fondi i kompensimit të pronave vlerësohet fond special, në kuptim të nenit 7 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Procedurat e propozimit dhe të miratimit të buxhetit të këtij fondi janë po ato që zbatohen për ligjin për Buxhetin e Shtetit dhe paraqiten së bashku me të për miratim në Kuvend.

3. Fondi i kompensimit të pronave përdoret për kompensimin në vlerë të subjekteve të shpronësuar, të cilave u është njohur e drejta e kompensimit, kur kthimi fizik i pronës së tyre ka qenë i pamundur.

Neni 3
Burimet e fondit të kompensimit të pronave

Burimet e fondit të kompensimit të pronave janë:

1. Të ardhurat, ku përfshihen:
 - a) të ardhurat nga Buxheti i Shtetit për kompensimin e subjekteve të shpronësuar, sipas ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar;
 - b) të ardhurat e realizuara nga shitja me ankand e pasurive shtetërore, për të cilat nuk ka vendim të dhënë nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave, në masën 65 për qind të vlerës së shitjes për objektet dhe 100 për qind të vlerës së shitjes për truallin;
 - c) të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar;
 - ç) të ardhura të tjera që, sipas ligjeve të veçanta apo akteve nënligjore, kalojnë për llogari të fondit të kompensimit të pronave.
2. Të ardhurat nga donatorë të ndryshëm.

Neni 4
Administrimi i fondit

1. Fondi i kompensimit të pronave administrohet nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit

të Pronave.

2. Fondi i kompensimit administrohet në një llogari të veçantë të thesarit në Bankën e Shqipërisë. Burimet që përbëjnë fondin e kompensimit të pronave, sipas nenit 3 të këtij ligji, arkëtohen dhe administrohen, sipas natyrës së tyre, nëpërmjet sistemit të thesarit.

3. Pavarësisht rregullit të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, gjendja e mjeteve monetare të papërdorura nga fondi i kompensimit të pronave në fund të vitit buxhetor, në llogarinë e veçantë në Bankën e Shqipërisë, mbartet për llogari të vitit të ardhshëm.

4. Llogaritë e fondit special të kompensimit të pronave paraqiten në Kuvend si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

5. Ministri i Financave përcakton me udhëzim mënyrën dhe procedurën për administrimin e fondit të kompensimit dhe rregullat për arkëtimin e administrimin e burimeve, që përbëjnë fondin e kompensimit.

Neni 5

Subjektet përfituese

1. Subjektet e shpronësuara, të cilave u është njohur e drejta për kompensim, në përputhje me ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, përfitojnë kompensim nga fondi i kompensimit në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pronarët, të cilëve u është njohur e drejta për shpërblim, në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përfitojnë kompensim nga fondi i kompensimit, në varësi të të ardhurave të arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelave ndërtimore.

3. Çdo subjekt i shpronësuar, të cilit i njihet e drejta e kompensimit të pronës me ligj të veçantë, përfiton kompensim nga fondi i kompensimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe/ose në ligjin që i njeh të drejtën e kompensimit.

Neni 6

Shpërndarja e fondit

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, në bazë të të ardhurave të arkëtuara, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, miraton shumën në dispozicion të pronarëve, të parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji dhe shtrirjen kohore të përfitimit të kësaj shume.

2. Pjesa e mbetur e fondit të kompensimit financiar përdoret për kompensimin e subjekteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji, në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit, në varësi të të ardhurave, që gjenden në fondin e kompensimit të pronave.

3. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes së vet zyrtare listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave për periudhën përkatëse.

4. Subjektet përfituese, në emër dhe për llogari të tyre, hapin një llogari bankare në njërin nga bankat e nivelit të dytë. Vërtetimin e lëshuar nga banka e dërgojnë pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e cila ia bashkëlidh dosjes së aplikimit.

5. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sipas fondit të vënë në dispozicion, shpërndan vlerën e kompensimit për subjektet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, nëpërmjet derdhjes së shumës në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Pagimi i shumës së depozituar në favor të subjekteve përfituese bëhet pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

Dokumentacioni i nevojshëm dhe procedurat për verifikimin e tij përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 7
Raportimi

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i raporton, me shkrim, periodikisht çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë për ecurinë e procesit të kompensimit financiar dhe për administrimin e fondit të kompensimit të pronave.

2. Ministri i Drejtësisë, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet raport me shkrim Kuvendit, brenda muajit mars të çdo viti, për ecurinë e procesit të kompensimit të procesit financiar të subjekteve të shpronësuar.

Neni 8
Parimet e nxjerrjes së akteve nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji nxirren duke respektuar parimet e kompensimit të drejtë, të barazisë para ligjit, sigurisë juridike, procesit të rregullt ligjor dhe proporcionalitetit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6465, datë 18.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 10 240, datë 25.2.2010

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007 “PËR INSPEKTIMIN E
NDËRTIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 10 shtohen nenet 10/1, 10/2 e 10/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

1. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë të ushtrojë përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të

bashkisë/komunës/qarkut, sipas shkronjës “d” të nenit 5 të këtij ligji, për ndërtime të kundërligjshme në territorin e bashkisë/komunës/qarkut, që nuk përfshihen në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, sipas këtij ligji, vetëm në rastet kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Ushtrimi i përgjegjësisë, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet vetëm kur në kantierin, objekt inspektimi, nuk ka filluar apo nuk është në proces një inspektim nga inspektorati vendor dhe është administruar dokumentacioni i plotë shkresor, që provon, përveç kundërligjshmërisë së ndërtimit, të paktën dhe njërën nga rrethanat e mëposhtme:

a) ushtrimi i përgjegjësisë kërkohej nga vetë inspektorati ndërtimor urbanistik vendor i komunës/bashkisë ose nga kryetari i komunës apo bashkisë përkatëse, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;

b) inspektorati ndërtimor urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për këtë ndërtim, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj;

c) vendimi i inspektoratit ndërtimor urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj.

Gjatë ushtrimit të kësaj detyre, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar ka përgjegjësinë të bëjë kallëzim penal për veprën penale të konstatuar dhe të paraqesë kërkesë për heqje licence, nëse punimet kryhen nga subjekte të pajisura me leje dhe licencë.

3. Fjala “ndërtim”, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme, në çastin e ushtrimit të inspektimit nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

4. Ushtrimi i përgjegjësisë, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, bëhet kryesisht ose me kërkesë të subjekteve publike ose private të interesuara.

Neni 10/2

1. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar ka përgjegjësi ekskluzive, në përputhje me këtë ligj, për ndërtimet e kundërligjshme, të përhershme apo të përkohshme, të ngritura mbi sipërfaqen ujore, përkatësisht mbi shtratin e lumenjve, liqeneve dhe deteve, pavarësisht nëse kanë ose jo pikë lidhjeje me bregun e lumit, liqenit ose detit. Në rastet kur inspektorati ndërtimor urbanistik vendor konstaton ekzistencën e ndërtimeve të tilla, ia përcjell çështjen për kompetencë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.

2. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kryen inspektimin, sipas pikës 1 të këtij neni, në njërin nga rastet e mëposhtme:

a) periodik, të paktën 1 herë në vit, në çdo mjedis të vënë në dispozicion të të tretëve nga shteti shqiptar, në bazë të marrëveshjeve koncesionare shtetërore;

b) brenda 15 ditëve pune, kur autoriteti kontraktor ose organi shtetëror i autorizuar, sipas rastit, depoziton një kërkesë me shkrim për rikthimin e ligjshmërisë së mjediseve të dhëna me koncesion shtetëror;

c) brenda 15 ditëve pune, kur administrata detare njofton se në mjediset ujore të porteve të shpallura zhvillohen ndërtime pa lejen përkatëse ose në kundërshtim me parashikimet e bëra në to;

ç) me kërkesë me shkrim të bashkisë/komunës/qarkut.

3. Fjala “ndërtim”, sipas pikës 1 të këtij neni, i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme, të përhershme/të përkohshme, në çastin e ushtrimit të inspektimit nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar. Shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përfshijnë edhe rastet e koncesioneve për ndërtime digash, hidrocentralesh dhe hidrovoresh.

4. Ministritë e linjës depozitojnë në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e marrëveshjes koncesionare, kopje të plota të këtyre marrëveshjeve dhe përcaktime konkrete të mjediseve, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, ku parashikohet të operojë koncesionari.

5. Në përfundim të çdo inspektimi, sipas pikës 2 të këtij neni, kopja e plotë e procesverbalit dhe/ose vendimit përkatës i dërgohet, për dijeni, autoritetit kontraktor ose organit shtetëror të autorizuar, sipas rastit, për inspektime, në përputhje me shkronjën “a” dhe çdo kërkuesi për inspektime, në përputhje me shkronjat “b”, “c” ose “ç” të pikës 2 të këtij neni.

Neni 10/3

Ushtrimi i përgjegjësisë, sipas neneve 10/1 e 10/2, kryhet sipas së njëjtës procedurë, të përcaktuar në nenet 12, 13 e 14 të këtij ligji.”.

Neni 2

Në nenin 15, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Gjobat, sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 e 6 të këtij neni, përbëjnë titull ekzekutiv.”.

Neni 3

1. Autoritetet kontraktore/organi shtetëror i autorizuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas rastit, depozitojnë pranë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kopje të plota të marrëveshjeve koncesionare në fuqi, ku parashikohen të kryhen ose janë kryer ndërtime në mjedise, sipas nenit 10/2 të këtij ligji dhe, kur i disponojnë në dosje, edhe lejet përkatëse, të dhëna për këtë qëllim nga organet përgjegjëse.

2. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të të dhënave që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni e të materialeve arkivore që administron, krijon regjistrin e të dhënave për ndërtimet e kryera ose eventuale në mjedisin e caktuar, sipas nenit 10/2 të këtij ligji, në të cilin do të kryejë përditësime pas çdo inspektimi, si dhe ka detyrim për mirëmbajtjen e tij.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6466, datë 18.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 10 241, datë 25.2.2010
PËR SIMBOLET E PËRKUJTIMIT TË VIKTIMAVE DHE TË KRIMEVE TË
KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e disa simboleve, në përkujtim të viktimave dhe të krimeve të shkaktuara nga regjimi komunist në Shqipëri.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me simbole nënkuptohen: muze, obelisk, monumente dhe një datë e përkujtimit publik të viktimave dhe të krimeve të shkaktuara nga regjimi komunist në Shqipëri.

Neni 3

Këshilli i Ministrave shpall datën 20 shkurt, ditën e rrëzimit të bustit të ish-diktatorit Enver Hoxha në Tiranë, si “Dita e përkujtimit të viktimave dhe të krimeve të komunizmit në Shqipëri”. Përkujtimi i kësaj date bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të krijojë Muzeun Kombëtar të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për ngritjen e Obeliskut të Viktimave dhe të Krimeve të Komunizmit në Tiranë, si dhe të monumenteve përkujtimore në qytetet e tjera të Shqipërisë.

Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 3, 4 e 5, të nxjerrë aktet nënligjore brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6467, datë 18.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ
Nr. 10 242, datë 25.2.2010
PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË
SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin dhe përcaktimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, në vijim “instituti”.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton kriteret, që duhet të plotësojnë punonjësit e institutit, si dhe tërësinë e kushteve për grumbullimin, administrimin e ruajtjen, në arkivin e institutit, të dokumenteve e të materialeve, që dëshmojnë krimet e komunizmit në Shqipëri.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Periudha e komunizmit” është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990, si dhe periudha përpara datës 29 nëntor 1944, gjatë së cilës është zhvilluar veprimtaria, që ka përgatitur ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila, më pas, u shndërrua në Partia e Punës e Shqipërisë.

b) “Krimet e komunizmit” janë veprimet e kryera nga funksionarët e shtetit komunist në periudhën e komunizmit, të cilat kanë të bëjnë me konceptimin, përpunimin apo vënien në zbatim të masave represive, të shoqëruara me shkelje të tjera të të drejtave të njeriut ose me akte që përbëjnë gjenocid, krime kundër njerëzimit, si dhe krime kundër jetës dhe shëndetit të individit, në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të legjislacionit penal.

c) “Funksionar i sistemit komunist” është funksionari publik ose personi që gëzonte mbrojtje të barabartë me atë të funksionarit publik, ku përfshihen, në mënyrë të veçantë, funksionarët shtetërorë dhe funksionarët e lartë partiakë.

ç) “Organet e diktaturës komuniste” janë organet që kanë vepruar gjatë periudhës së komunizmit dhe, konkretisht, ish-Sigurimi i Shtetit, organet e inteligjencës në ushtri, Ministria e Brendshme, Policia Popullore, forcat kufitare, repartet e ndjekjes në Ministrinë e Brendshme, si dhe personeli i burgjeve e i kampeve të internimit.

Në organe të diktaturës komuniste vlerësohen edhe pjesëmarrja dhe veprimtaria e njëjseve, strukturave dhe individëve të hetuesisë, prokurorisë e gjykatave, në shërbim të veprimtarisë së strukturave të përmendura në këtë paragraf.

KREU II
INSTITUTI I STUDIMEVE TË KRIMEVE DHE TË PASOJAVE
TË KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

Neni 4
Statusi i institutit

1. Instituti është institucion publik, qendror, i pavarur dhe gëzon statusin e personit juridik.
2. Instituti financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera.
3. Instituti e ka selinë në Tiranë dhe ka stemën e vet.

Neni 5

Detyrat

Instituti kryen këto detyra kryesore:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;
- ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;
- gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;
- i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;
- j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;
- k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja.

Neni 6
Bashkërendimi

1. Instituti është i autorizuar të përdorë të dhëna personale, kur është e domosdoshme, për përmbushjen e detyrave, duke garantuar privatësinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të gjitha strukturat dhe organet shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat, tërësisht ose pjesërisht buxhetore, organizatat që financohen nga qeverisja vendore, arkivat dhe të gjitha njësitë apo strukturat e tjera, që disponojnë dokumente e materiale arkivore, që i përkasin periudhës së komunizmit dhe që mund t'i shërbejnë realizimit të veprimtarisë së institutit, janë të detyruara t'ia vënë ato në dispozicion dhe t'i ofrojnë institutit asistencën e nevojshme, pa pagesë dhe pa vonesë të pajustificuar. Instituti ka të drejtë të bëjë kopje të dokumenteve dhe të materialeve arkivore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

Neni 7
Organet drejtuese

Organet drejtuese të institutit janë:

- a) bordi;
- b) drejtori ekzekutiv.

Neni 8
Bordi i institutit

1. Bordi i institutit (më tej “bordi”) është organi më i lartë drejtues. Ai përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen dhe lirohen nga Kuvendi, në bazë të një liste kandidatësh të propozuar nga:

- a) Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë (3 anëtarë);
- b) shoqëria civile (1 anëtar);
- c) Akademia e Shkencave (1 anëtar);
- ç) Konferenca e Rektorëve (2 anëtarë).

Për çdo vend për anëtar bordi propozohen 3 kandidatë.

2. Anëtarët e bordit duhet të jenë personalitete të njohura nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile, të cilët zotërojnë aftësi profesionale dhe kanë dhënë kontribut, që krijojnë bindje se mund të mbështesin institutin në realizimin e misionit e të detyrave të tij. Anëtarët e bordit duhet të plotësojnë të gjitha kushtet, që parashikojnë aktet ligjore dhe nënligjore për nëpunësit e lartë të shërbimit civil, si dhe kushtet e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji.

3. Anëtarët e bordit zgjidhen për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Mandati i anëtarit të bordit është i papajtueshëm me funksione të larta shtetërore, kushtetuese, politike, administrative, si dhe me anëtarësinë në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Mandati i anëtarit të bordit është, gjithashtu, i papajtueshëm edhe me anëtarësinë në parti dhe lëvizje politike.

Neni 9
Përfundimi i mandatit

1. Mandati i anëtarit të bordit përfundon kur:

- a) mbaron kohëzgjatja e mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) zgjidhet apo emërohet në funksione, që janë të papajtueshme me mandatin e anëtarit të bordit;
- ç) deklarohet i paaftë për të vepruar, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

- d) dënohet, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi;
 - dh) vërehen akte e sjellje, që cenojnë rëndë figurën e anëtarit të bordit;
 - e) vdes.
2. Kuvendi liron nga detyra një anëtar bordi kur vërtetohet se:
- a) ka dhënë informacion të pavërtetë për përmbushjen e kriterëve që parashikon pika 2 e nenit 8 të këtij ligji;
 - b) nuk merr pjesë në veprimtarinë e bordit për një periudhë mbi 6 muaj, përjashtuar rastet e mungesës për arsye shëndetësore.

Neni 10 **Vendimmarrja**

- 1. Bordi zgjedh, me shumicën e votave të anëtarëve, kryetarin dhe nënkryetarin e tij.
- 2. Mbledhjet e bordit thirren nga kryetari i bordit dhe, në mungesë të tij e me porosi, nga nënkryetari.
- 3. Bordi merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve.
- 4. Bordi funksionon sipas parimit të barazisë së anëtarëve.

Neni 11 **Detyrat e bordit**

- 1. Detyrat kryesore të bordit janë:
 - a) përcakton metodat për përmbushjen e detyrave të institutit;
 - b) zgjedh, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, drejtorin ekzekutiv të institutit;
 - c) miraton planin vjetor të punës;
 - ç) propozon në Këshillin e Ministrave strukturën, organikën dhe buxhetin vjetor të institutit;
 - d) miraton rregulloren e funksionimit të institutit;
 - dh) miraton planin vjetor të botimeve, publikimeve, dokumentarëve dhe veprimtarive të tjera përkujtimore;
 - e) miraton përbërjen e këshillit shkencor të institutit, si organ këshillimor i bordit;
 - ë) miraton kriteret e kualifikimit, si dhe procedurat e marrjes në punë të punonjësve të institutit;
 - f) vendos për ankesat kundër vendimeve të institutit;
 - g) miraton raportin vjetor të institutit dhe raporton në Kuvend;
 - gj) i dërgon raportin vjetor për dijeni edhe Këshillit të Ministrave;
 - h) monitoron dhe vlerëson sigurinë e aksesit në dokumentacionin e në materialet arkivore të institutit.
- 2. Bordi ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit të Ministrave mbështetjen e shërbimit diplomatik të vendit, për akses në dokumente të nevojshme në arkivat e huaj, për realizimin e veprimtarisë së institutit.

Neni 12 **Mënyra e shpërblimit**

Kryetari, nënkryetari, anëtarët e bordit dhe anëtarët e këshillit shkencor të institutit punojnë me kohë të pjesshme dhe përfitojnë një shpërblim mujor të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13 **Drejtori ekzekutiv**

- 1. Instituti drejtohet nga drejtori ekzekutiv.
- 2. Drejtori ekzekutiv zgjidhet për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë, në përputhje me përcaktimet e bëra në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 11 të këtij ligji.

Drejtor ekzekutiv mund të zgjidhet çdo shtetas shqiptar, që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji.

3. Drejtori ekzekutiv përfaqëson institutin në marrëdhënie me të tretët.

4. Detyrat kryesore të drejtorit ekzekutiv të institutit janë:

a) përgatit të gjitha materialet, që shqyrton dhe miraton bordi dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të bordit;

b) merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e bordit;

c) i propozon kryetarit të bordit datën e mbledhjes dhe rendin e ditës;

ç) u propozon organeve/institucioneve, që parashikon ligji, sanksione për shkeljet administrative, të bëra nga institucionet që kanë ruajtur materialet arkivore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, dosjet dhe informacionin e klasifikuar;

d) emëron dhe liron punonjësit e institutit;

dh) nënshkruan akte bashkëpunimi me titullarët e institucioneve, që zotërojnë dokumente e materiale arkivore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve e të materialeve arkivore të kësaj natyre.

Neni 14

Këshilli shkencor i institutit

1. Këshilli shkencor i institutit është organ këshillimor i bordit të institutit dhe përbëhet nga shtatë anëtarë, studiues të njohur nga bota akademike dhe shoqëria civile.

2. Përbërja e këshillit shkencor miratohet me vendim të bordit. Detyrat dhe mënyra e funksionimit të këshillit shkencor të institutit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga bordi i institutit.

KREU III

FUNKSIONIMI I ARKIVIT TË INSTITUTIT

Neni 15

Arkivi i institutit

1. Arkivi është pjesë e institutit. Ai funksionon në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për arkivat dhe realizon detyrat e mëposhtme:

a) riprodhon, fotokopjon dhe ruan në arkiv të gjitha dokumentet e materialet, që rezultojnë nga veprimtaria e zhvilluar gjatë periudhës së komunizmit nga organet e diktaturës komuniste, Partia e Punës e Shqipërisë, Fronti Demokratik i Shqipërisë, si dhe nga çdo organizatë, institucion apo strukturë tjetër, që zotërojnë dokumente arkivore, të cilat i shërbejnë institutit për studimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “dh” të pikës 4 të nenit 13 të këtij ligji;

b) grumbullon dhe ruan dokumente e materiale arkivore, që kanë lidhje me organet e diktaturës komuniste, të cilat dorëzohen në institut nga qytetarë, organizata të ndryshme, persona fizikë e juridikë, vendas a të huaj;

c) publikon dhe siguron aksesin për dokumentet dhe materialet arkivore, që kanë lidhje me organet e diktaturës komuniste, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për përdorimin e tyre;

ç) siguron akses për dokumente e materiale arkivore, jep informacion dhe asiston institucionet e organet, që gëzojnë të drejtën e përdorimit/shfrytëzimit të materialeve të sipërpërmendura, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) administron punën me dokumentet dhe materialet arkivore në institut;

dh) jep vlerësim për ankesat e kërkuësve, që nuk u është dhënë e drejta e aksesit në materialet arkivore, ose nuk janë lejuar të bëjnë përmbledhje, kopje apo transkripte të tyre;

e) u jep kopje dhe transkripte nga dokumentet/materialet e depozituara në arkiv institucioneve apo organeve publike, qendrore apo të qeverisjes vendore, si dhe personave fizikë a juridikë të autorizuar nga ligji;

ë) lejon këqyrjen e materialeve arkivore, të depozituara në kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat;

f) ruan regjistrin e materialeve të arkivuara;

g) bashkëpunon me arkivat e tjera dhe institucionet shkencore, kulturore e arsimore për shkëmbimin e informacionit dhe të ekspertizës në punën kërkimore dhe në shfrytëzimin/përdorimin e materialeve arkivore, për qëllime kulturore, arsimore, shkencore dhe ekonomike dhe, veçanërisht, për studimin e historisë e të gjeografisë kombëtare;

gj) krijon një bibliotekë të specializuar në fushën e veprimtarisë së arkivit;

h) realizon botime në fushat e veprimtarisë së institutit;

i) në bashkëpunim me Arkivin Qendror të Shtetit, siguron ruajtjen dhe restaurimin e materialeve arkivore.

2. Arkivi ka të drejtë të përdorë edhe të dhëna personale, vetëm për aq sa është e domosdoshme, në përmbushjen e detyrave të tij dhe duke garantuar privatësinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 16

Përbashkrimet

Drejtori ekzekutiv i institutit ka të drejtë të mos lejojë akses në dokumente apo materiale arkivore, kur këto materiale kanë status të klasifikuar dhe nuk lejohet bërja e tyre publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ankesat kundër këtij vendimi i drejtohen bordit.

Neni 17

Raportimi dhe konfidencialiteti

1. Drejtori ekzekutiv i institutit i dërgon bordit, çdo gjashtë muaj, një raport dhe përgatit shpjegime, që ndihmojnë bordin për monitorimin dhe vlerësimin e sigurisë së aksesit në dokumentet dhe materialet arkivore. Bordi ka të drejtë të njihet me çdo informacion për vendimet e marra për moslejimin e aksesit në dokumentet dhe materialet arkivore.

2. Anëtarët e bordit duhet të respektojnë detyrimin e heshtjes për 5 vjet, për informacionet dhe materialet arkivore, për të cilat arkivi nuk ka lejuar akses. Ky afat vlen edhe pas përfundimit të mandatit si anëtar i bordit.

KREU IV

KËRKESA TË VEÇANTA PËR NËPUNËSIT E INSTITUTIT

Neni 18

Kriteret e veçanta

1. Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990 dhe nuk ka qenë:

a) anëtar ose kandidat i PKSH-së a PPSH-së;

b) i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit ose mbrojtjes të Shqipërisë a të vendeve të Traktatit të Varshavës;

c) funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit;

ç) anëtar ose bashkëpunëtor i shërbimeve inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës.

2. Plotësimi i kërkesave, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni verifikohet përmes dokumenteve të lëshuara nga organet/institucionet që parashikon ligji.

Neni 19

Marrëdhëniet e punës, struktura dhe organika e institutit

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të institutit rregullohen nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve të tjerë të institutit rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Struktura, organika dhe niveli i pagave të punonjësve të institutit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 20

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave:

a) të sigurojë mjediset e punës për institutin brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji;
b) të miratojë strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të nëpunësve e të punonjësve të tjerë të institutit dhe të shpërblimeve brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 12 dhe 19 të këtij ligji.

2. Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas përcaktimeve në nenet 8 pikat 1 e 2 dhe 13 pika 2 të këtij ligji, të emërohen bordi i institutit dhe drejtori ekzekutiv i institutit.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6468, datë 18.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr. 25, datë 19.3.2010

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TRANSPARENCËN E ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME, TË MBAJTURA MË 28 QERSHOR 2009

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të pikave 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor i Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të realizuar transparencën e plotë të procesit të zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 28 qershor 2009.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

a) hetimi i akuzave dhe dyshimeve publike të bazuara, të ngritura nga partitë politike, si dhe vëzhguesit vendas e ndërkombëtarë, për zbatimin e legjislacionit në lidhje me procesin zgjedhor;

b) hetimi i dyshimeve dhe akuzave të bazuara, të ngritura nga partitë politike, si dhe vëzhguesit vendas e ndërkombëtarë, për proces të parregullt votimi në qendrat e votimit;

c) hetimi i veprimtarisë së administratës së KQZ-së, në lidhje me përdorimin e teknologjisë mbështetëse të monitorimit në procesin e numërimit të votave;

ç) hetimi i akuzave publike të bazuara për përdorimin e mjeteve publike, si dhe të administratës në favor të subjekteve të caktuara zgjedhore;

d) hetimi i akuzave të bazuara për presione të ushtruara për largim, transferim apo ulje në detyrë të punonjësve në administratën qendrore, vendore apo të çdo enti publik për shkaqe që lidhen me fushatën, të kryera gjatë periudhës 29 maj - 28 qershor 2009, si dhe periudhën vijuese pas saj;

dh) hetimi i rasteve të dhënies, në kundërshtim me ligjin, të lejeve të përkohshme për personat e dënuar, apo duke vuajtur masën e sigurisë arrest me burg, nga administrata e burgjeve gjatë periudhës 29 maj - 28 qershor 2009;

e) çdo shkelje tjetër që lidhet me procesin zgjedhor që do të rezultojë gjatë hetimit.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje, përveç çështjeve për të cilat ka vendime të gjykatave të vendit, janë në shqyrtim gjyqësor apo për të cilat është regjistruar kallëzim penal në prokurori. Objekti i hetimit duhet të jetë i argumentuar dhe duhet të përmbajë fakte ose kompleks faktesh, të cilat tregojnë qartë se për çfarë po hetohet.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim ndalimin përfundimtar të fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 15 deputetë. Kryetari i përket Partisë Socialiste. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

- | | |
|----|------------|
| 1. | kryetar PS |
| 2. | “ |
| 3. | “ |
| 4. | “ |
| 5. | “ |

- | | |
|----------------------|------|
| 6. | “ |
| 7. | “ |
| 8. Ilir Rusmali | PD |
| 9. Eduard Halimi | “ |
| 10. Enkelejd Alibeaj | “ |
| 11. Aldo Bumçi | “ |
| 12. Arenca Trashani | “ |
| 13. Viktor Gumi | “ |
| 14. Edi Paloka | “ |
| 15. Nasip Naço | LSI. |

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM **Nr.104, datë 17.2.2010**

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2010, PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 117 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2010, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, në shumën 230 500 000 (dyqind e tridhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë, të ndarë sipas zërave, të paraqitur në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARAE PËR VITIN 2010

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzimet gjithsej:	230 500 000
1.	Paga	67 000 000
2.	Kontribut i sigurime shoqërore e shëndetësore	8 500 000
3.	Materiale	5 000 000
4.	Shërbime	30 000 000
5.	Investime	120 500 000

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 23.3.2010

Doli nga shtypi më 23.3.2010

Tirazhi: 3000 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë